

Titulli i Lëndës: KIMIA ORGANIKE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë-TUBT
Titulli i lëndës:	Kimi organike
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I^{rë} /semestri i II^{të}
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E Marte /8³⁰-10⁰⁰/ Amfiteatër
Mësimdhënësi i lëndës:	Arleta Rifati-Nixha
Detajet kontaktuese:	email: arleta.rifati@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Në këtë kurs të Kimisë Organike, do të mësohen konceptet bazë të Kimisë Organike si dhe do të mësohen të gjitha klasët e komponimeve organike, duke filluar nga struktura dhe vetitë e komponimeve organike, hidrokarburet e ngopura (struktura, përftimi dhe reaksionet), hidrokarburet e pangopura (struktura, përftimi dhe reaksionet), hidrokarburet aromatike (struktura, përftimi dhe reaksionet), halogjenuret organike (struktura, përftimi dhe reaksionet), alkoolet, fenolet, eteret dhe tiolet (struktura, përftimi dhe reaksionet), aldehidet dhe ketonet (struktura, përftimi dhe reaksionet), acidet karboksilike dhe derivatet e tyre (struktura, përftimi dhe reaksionet), aminat dhe alkaloidet (struktura, përftimi dhe reaksionet), stereoizomerizmi dhe aktiviteti optik, lipidet, lyrat, vajrat dhe dyllrat, karbohidratet (struktura, përftimi dhe reaksionet), amino acidet dhe proteinet dhe acidet nukleike.
Qëllimet e lëndës:	Që studentët të njihen dhe të familjarizohen me Kiminë Organike, të njohin strukturën dhe reaktivitetin e komponimeve organike, të mësojnë nomenklaturën dhe reaktivitetin e grupeve funksionale të klasëve të ndryshme të komponimeve organike, etj.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none">- Të diskutojnë për lidhjet e karbonit dhe pse është ai i pranishëm në aq shumë komponime të ndryshme.- Të mësojnë të përdorin modelet që ti projektojnë strukturat kimike të komponimeve të ndryshme si dhe të krahasojnë reaktivitetin e tyre.

	<p>- Të shpjegojnë lidhjen mes strukturës dhe vetive fizike e kimike të komponimeve, si dhe të japin mendime dhe parashikime lidhur me këto veti.</p> <p>- Të mësojnë tu qasen problemeve kimike në mënyrë sistematike dhe logjike.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime (pune praktike, seminare, ushtrime, etj)	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Projekte, prezantime, etj.	1	9	9
Koha e studimit vetanak	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	3	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	1	15	15
Totali	12	102	150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, punë seminarike, diskutime, ushtrime eksperimentale.		
Metodat e vlerësimit:	Kollokviumi i parë: 15% Kollokviumi i dytë: 15% Vijimi i rregullt: 5% Provimi final: 65% Total: 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Majlinda Daci Ajvazi, Kimia Organike për Shkencat e Jetës, Universiteti i Prishtinës, 2019. 2. Peter Vollhardt, Neil Schore, Organic Chemistry, 8th edition, New York, 2018. 3. Nexhat Daci, Majlinda Daci-Ajvazi, Kimia Organike, botimi i IV^{të}, Libri Shkollor, 2009, Prishtinë. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Francis A. Carey, Organic Chemistry, McGraw Hill, New York, 8th edition, 2010. 		

	2. J.Clayden, N.Greeves, S.Warren, Organic Chemistry, Oxford University Press, Inc., New York, 2 nd edition, 2012.
	3.

Plani i dizajnuar i mësimimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java 1:</i>	Njoftimi i studentëve me syllabusin e lëndës dhe literaturën. Hyrje në kimi organike, zhvillimi i kimisë organike, gjendja e tanishme, si të studiohet kimia organike.
<i>Java 2:</i>	Lidhja në komponime organike, lidhjet kimike, rezonanca, fotografia orbitale e lidhjeve kovalente, formimi i lidhjeve kovalente me mbimbështjellje të orbitale atomike, hibridizimi i orbitaleve atomike, hibridizimi sp^3 , sp^2 dhe sp , polariteti i lidhjeve dhe i molekulave, forcat tërheqëse dhe intermolekulare, natyra e reaksioneve kimike.
<i>Java 3:</i>	Hidrokarburet e ngopura, alkanet dhe cikloalkanet.
<i>Java 4:</i>	Hidrokarburet e pangopura, alkenet, alkinet dhe dienet.
<i>Java 5:</i>	Hidrokarburet aromatike, benzeni dhe derivatet e tij.
<i>Java 6:</i>	Halogjenuret organike.
<i>Java 7:</i>	Alkoolet, fenolet, eteret dhe komponimet e ngjashme të sulfurit.
<i>Java 8:</i>	Aldehidet dhe ketonet.
<i>Java 9:</i>	Acidet karboksilike dhe derivatet e tyre.
<i>Java 10:</i>	Aminat dhe alkaloidet.
<i>Java 11:</i>	Stereoizomerizmi dhe aktiviteti optik.
<i>Java 12:</i>	Lipidet, lyrat dhe dyllrat.
<i>Java 13:</i>	Karbohidratet.
<i>Java 14:</i>	Amino acidet dhe proteinet.
<i>Java 15:</i>	Acidet nukleike.

Plani i dizajnuar i mësimimit:

Java	Ushtrimet që do të zhvillohen
<i>Java 1:</i>	Siguria në laboratorin e kimisë, aparaturat dhe paisjet e laboratorit.
<i>Java 2:</i>	Ekstraktimi i thjeshtë.
<i>Java 3:</i>	Kristalizimi, rikristalizimi, përfitimi i aspirinës.
<i>Java 4:</i>	Pika e shkrirjes (çaktimi i pikës së shkrirjes me aparaturën e Thiele-t).
<i>Java 5:</i>	Distilimi-distilimi i thjeshtë.
<i>Java 6:</i>	Analiza cilësore e komponimeve organike. Analiza elementare.
<i>Java 7:</i>	Identifikimi i hidrokarbureve-alkanet, alkenet dhe hidrokarburet ciklike
<i>Java 8:</i>	Identifikimi i hidrokarbureve aromatike.
<i>Java 9:</i>	Identifikimi i alkooleve dhe fenolëve.
<i>Java 10:</i>	Identifikimi i aldehideve dhe ketoneve.
<i>Java 11:</i>	Identifikimi i acideve karboksilike dhe estereve.
<i>Java 12:</i>	Izolimi i kafeinës prej gjetheve të çajit.
<i>Java 13:</i>	Identifikimi i karbohidrateve dhe proteinave.

<i>Java 14:</i>	Identifikimi i lipideve. Testi i tretshmërisë.
<i>Java 15:</i>	Kollukfium dhe vlerësimi intermedier.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
--

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime si dhe aktiviteti gjatë orëve të mësimit është i domosdoshëm për çdo student.
